



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT /SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL
ASSEMBLY ISTOG



Komuna e Istog
Opština Istok
Municip

01.Nr: 553/2022

Datë: 01.08.2022

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Istogut dhe shoqëria civile, se më datën: **15.08.2022, ditë e Hënë, duke filluar në ora 11:00**, në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati i III-të, do të organizohet: Konsultim publik me qytetar për:

PROJEKT – RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSIVE

Kjo Rregullore është e një rëndësie të veçantë për Komunën e Istogut, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoni të drejtën e juaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këtë Konsultim publik që është një proces i vendimmarrjes ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni që kjo Rregullore të jetë sa më e kompletuar dhe cilësore.

Zëri i juaj do të dëgjohet!

Një kopje të Rregulloreve mund ta merrni në Zyrën Ligjore Nr. 312, kati i III-të.

E mirëpresim pjesëmarrjen tuaj.

Istog, më: 01.08.2022



Drejtori i Arsimit

Naim Behlulaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Istog
Opstina Istok
Municipal Istog

PROCESVERBAL NGA DËGJIMI PUBLIK PËR DRAFT RREGULLOREN PER NDARJEN E BURSIVE.

Me datë:15.8.2022 në ora 11,në sallën e Kuvendit të Komunës është mbajtur Dëgjimi publik me qytetar lidhur me Draft Rregulloren komunale për ndarjen e bursave per student dhe nxënës.

Në këtë dëgjim publik ishin të pranishëm:Drejtori i DKA-se,z.Naim Behlulaj,nënkryetari z.Ali Nimanaj,komisioni që ka punuar në këtë rregullore si dhe qytetaret,
Fjalën hyrse e bëri drejtori i DKA-së z.Naim Behlulaj,i cili përshëndeti të pranishmit dhe falenderoj komisionin për punën e shkëlqyer,Poashtu të pranishmit i pershendeti edhe nenkryetari z.Ali Nimanaj.

Drejtori z.Behlulaj elaboron në pika të shkurta thelbin e rregullores.Është rregullore qe ka ndryshime të mdhaja dhe per ketë quhet Draft.

Kjo rregullore është bazuar në strategjinë e zhvillimit të MASHT-it 2022-2026.

Risi e kësaj rregullore është se përveq studenteve mund të jenë përfitues edhe nxënësit dhe studentet e universiteteve nderkombëtare.Poashtu ndryshim është edhe rritja e totalit të bursës për studentë nga 600 ne 700 euro,kurse per studentet e universiteteve nderkombetare 1000 €.

Diskutimet:

- **Hanife Imeraj**-kërkesa e kësaj është që përfitues të jenë edhe studentët që studiojnë në universiteteve private.
- **Sali Blakaj-jap** vërejtje për pjesmarrjen e ultë e qytetarëve në dëgjime publike.Të krijohen kushte më të mira për studentët në mënyrë që të studiojnë në universitete publike,si dhe ata që përfundojnë studimet të ju epet mundësia e punësimit në mënyrë që të punësohen në vend e mos të ikun jashë shteti.
- **Haki Rugova**-rastet sociale dhe të papunët a kanë përparësi.
Përgjigjja e z.Behlulaj ishte-do të poentohen nëbazë të kushteve dhe kriterëve qe janë të parapara me rregullore.
- **Arlind Balaj**-sygjerorj që tek Neni.9,pika 1 të shtohet“mbi 18 vjeq”.

Drejtori i DKA-se z.Behlulaj falënderon të pranishmit,dhe së bashku me komisionin e perpilimit te kësaj rregullore do të shohin mundësinë se a ka bazë ligjore të inkorporohen keto sygjerimet e juaja.z.Behlulaj mbyllë diskutimin në ora.12.15 min.

Procesmbajtësja
Zize Bujupaj

Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Istog, 15.8.2022



Plani i Komunës së Istogut rreth Konsultimeve Publike

Komuna: Istog	Pjesëmarrësit në konsultime publike: - Qytetarët e të gjitha fshatrave të komunës së Istogut, - OJQ-të, - Etj.		Buxheti : - I pa përcaktuar
Qëllimi i Konsultimit: PROJEKT RREGULLLOREN PËR NDARJEN E BURSARE	Procesmbajtësit: Zize Bujupaj		
Objektivat/ Synimet e Konsultimit: Gjithpërfshirja e qytetarëve në dëgjime publike, dhe transparencë për të gjithë	Të tjerë: - Kryetari i Komunës - Drejtorët e Drejtorive		
Çështjet kyçe të konsultimit - Tema: - PROJEKT RREGULLLOREN PËR NDARJEN E BURSARE	Akterët e brendshëm - Drejtoria për Arsime - Komuna e Istogut	Akterët e jashtëm - Qytetarët - OJQ-të	Komunikimi dhe Mediet: - Mediet Lokale dhe qendrore - Qytetarët dhe OJQ-të
Informacioni: Çfarë materiali i ofrohet akterëve për dëgjim publik	Strategjitë për përfshirjen e qytetarëve në dëgjime publike		Rezultatet e pritura : - Arrija e plotësimit ndryshimit të PROJEKT RREGULLLORES PËR NDARJEN E BURSARE
Cili është informacioni që presim të marrim: - Rekomandime dhe propozime për PROJEKT RREGULLLOREN PËR NDARJEN E BURSARE			Opsionet e raportimit: - Verbale - Me shkrim
Metodat e Konsultimit: - Verbale dhe me shkrim			Fushat kryesore të vlerësimit: - Projekt rregullorja sipas ekspertëve dhe propozimeve të qytetarëve
Procesi i Konsultimit:			Procesi i Konsultimit publik:
Data e fillimit 15.08.2022			Data e mbarimit 15.08.2022



Raport nga procesi i takimit publik lidhur me Projekt – Rregulloren për Ndarjen e Bursave të Komunës së Istogut.

Komuna e Istogut me saktësisht Drejtoria për Arsim ka mbajtur takim publik me qytetar lidhur me konsultim Publik me Qytetarë për PROJEKT – RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSAVE. Drejtori Naim Behlulaj i ka njoftuar të pranishmit për Hartimin e PROJEKT – RREGULLORES PËR NDARJEN E BURSAVE.

Ky takim është thirrur me datë 01.08.2022, takimi ishte thirrur në uebfaqen e komunës, rrjetin social facebook, poashtu edhe përmes medias lokale.

<https://kk.rks-gov.net/istog/news/njoftim-per-degjim-publik-14/>

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=435202448635023&set=a.297291759092760>

Nr.	Metodat e Konsultimit	Datat / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve
1	Konsultim me qytetarë në Kuvendin Komunal	15.08.2022	TOTAL : 25 Pjesëmarrës
2	Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike	uebfaqe, facebook, media lokale	
3	Dëgjimi me qytetare	Takim me Qytetare në sallën e Kuvendit	
4			

Në takimin e mbajtur me 01.08.2022 qytetarët pjesëmarrës kanë kërkuar që kërkesat e tyre të jen pjesë e Rregullores për ndarjen e Bursave.